



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivered	18.11.2021	1 viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM SHCK	5527/2021		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

Anr.828/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.828/2021 të datës 23.09.2021 të parashtruar nga ankuesi _____ përmes përfaqësuesit me autorizim Fadil Sinanaj avokat nga Gjilani, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen administrativ- juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, në mënyrë unanime, me datë 17.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.828/2021 e datës 23.09.2021 e parashtruar nga ankuesi _____

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 089/21 i datës 23.08.2021, i Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje".

A r s y e t i m

Ankuesi _____ Zëvendës Drejtor në Qendrën Paraburgimit në Gjilan, në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, përmes përfaqësuesit me autorizim, me datë 23.09.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër protokolli 089/21, të datës 23.08.2021 të Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 05.10.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Shërbimi Korrektues i Kosovës. Ndërsa me datë 14.10.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Në mbështetje të nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe duke marrë parasysh rrethanat e funksionimit të KPMSHCK-se, me Vendimin nr.42/2021 të datës 05.11.2021 të Kryesuesit të KPMSHCK-së është vazhduar afati për vendosje të ankesës me numër A.828/2021 të datës 23.09.2021 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.828/2021 me numër protokolli 4753/2021 të datës 23.09.2021, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 05.10.2021; Vendim me numër VK.nr.42/2021 i datës 08.11.2021; Kërkesën për shtyrje të afatit për vendosjen e ankesës Nr.42 të datës 08.11.2021; Ndezja e dyshekut në dhomë e datës 04.07.2021; Raport-Njoftim për Zjarr vënie në dhomë-L4 i datës 04.07.2021; Formën për raportimin e incidentit Zjarr i datës 04.07.2021; Fotografi me rastin e incidentit dhoma e të burgosurit; Komunikimi në Viber i datës 04.07.2021; E-mailin nga F.H. për I.K. i datës 05.07.2021 në lidhje me rastin e incidentit të datës 04.07.2021 ndezja e dyshekut në dhomë QPGJ; E-mailin nga F.D. për F.H. i datës 05.07.2021; E-mailin nga M.M. për F.D. i datës 05.07.2021; Njoftimin e datës 05.07.2021; Aktvendimin PPr.nr.144/21 i datës 02.07.2021; E-mail nga F.H. për M.SH. i datës 06.07.2021; E-mail nga F.S. për F.H. të datës 06.07.2021; E-mailin nga F.S. për F.A. i datës 06.07.2021; E-mailin nga F.A. për F.S. të datës 06.07.2021; Vendimin e datës 09.07.2021; E-mailin nga F.H. për R.S. i datës 14.07.2021 Informim për të paraburgosurin H.S. vepra "kanosje" i pranuar më 02.07.2021 në QPGJ; E-mailin nga M.M. për I.I. i datës 13.07.2021 Urdhëresë për ekzaminim psikiatrik; E-mailin nga B.Y për A.G. i datës 13.07.2021 Urdhëresën për ekzaminim psikiatrik; Vendimin me nr. 089/21 i datës 23.08.2021; Autorizimin e datës 22.09.2021; Shkresat e lëndës për ankesën A.nr.828/2021 i datës 14.10.2021; Ankesa e zv. Drejtorit F.H. drejtuar KPM të SHC. i datës 08.10.2021; Hetimi i menaxhimit të rastit të zjarrit i datës 04.07.2021; Raportin Përfundimtar i datës 03.08.2021; E-mailin nga SH.S. për H.L. i datës 02.07.2021 Njoftim; Kërkesën për pushim vjetor nga SH.S. i datës 03.07.2021; Kontratën e Punës për Kohë të Caktuar prej datës 01.10.2017 deri më 30.09.2022; Rekomandimi për përtëritjen e kontratës i datës 08.09.2017; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 05.01.2012.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore si dhe pas analizimit të të gjitha provave të parashtruara nga palët, konstatoi që ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Nga shkresat e lëndës rezulton së ankuesi është i sistemuar në pozitën e punës "Zëvendës Drejtor i Përgjithshme në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan/Shërbimi Korrektues i Kosovës" me kohëzgjatje nga 01.10.2017 deri me 30.09.2022.

Me datë 23.08.2021 Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan në cilësi të Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, duke u bazuar në Raportin Hetimor lidhur me rastin HD-05/01/21-Zjarri të datës 03.08.2021, ka shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore "Vërejte", për shkak të shkeljes së detyrave të punës nga neni 43 paragrafi 4 nen paragrafi 4.2 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik si dhe nenin 4 paragrafi 1.4 dhe 1.5 të Rregullores Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Kosovës.



Ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se Vendimi i kundërshtuar më ankesë, është i pa bazuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke shtuar me tej se bazuar në Rregulloret e Brendshme dhe Rendin Shtëpiak, të paraburgosurve ju lejohet pirja e duhanit në dhomat e tyre duke nënkuptuar dhe posedimin e shkrepsës, dhe se në ditën e ngjarjes vet Drejtori i Përgjithshëm ka qenë përgjegjës për institucionin sepse ai pushimin e ka filluar nga data 05.07.2021.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga data 09.07.2021 përkatësisht sipas nenit 4 paragrafi 1 të këtij Ligji me te cilin është përcaktuar se: *Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë*, rrjedhë se me hyrjen në fuqi të këtij ligji, nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht se të njëjtit i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për nëpunësit civil si dhe ligjeve të veçanta nga fushëveprimi i Shërbimit Korrektues.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht kapitullin IV, lidhur me Disiplinën në Shërbim Civilë, si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, me të cilën është rregulluar procedura dhe masat disiplinore për nëpunësit civil, ndërsa në aspekt të përgjegjësisë disiplinore, Kolegji ju referua nenit 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili ka përcaktuar se: *"përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit.*

Po ashtu, Kolegji për vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të goditur me ankesë, ju referua dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit përkatësisht neni 11 paragrafi 1 dhe 5 i këtij ligji ka përcaktuar se " 1. Ndalohet pirja e duhanit në: 1.1. hapësirë publike; 1.2. hapësirë të punës; 1.3. mjetet e transportit publik; 1.4. hapësirat e hapura të përcaktuara në paragrafin 3. të këtij neni.....4. Me përjashtim të paragrafit 1,2 dhe 3 të këtij neni, pirja e duhanit lejohet vetëm në hapësirat dedikuara për pirjen e duhanit në institucionet ku trajtohen personat e palëvizshëm, personat me çrregullime mendore, ku strehohen personat e moshuar, dhe në institucionet korrektuese" si dhe Udhëzimin Administrativ MD-Nr.07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet korrektuese respektivisht nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 më të cilin parashihet se " 1.Personit të dënuar ose të paraburgosur prej sendeve për përdorim personal në institucionin korrektues i lihen:.....1.4. cigaret dhe mjetet për pirje të duhanit;

Nga vlerësimi i provave të lëndës respektivisht bazuar në Raportin e Komisionit Hetimor të datës 03.08.2021 si dhe deklaratimet e zyrtareve të pranishëm në datën e ngjarjes, Kolegji ka gjetur se me datë 04.07.2021 i burgosuri H.S qëllimisht ka shkaktuar zjarr në dhomën e tij #03 krahu 1/4. Personeli prezent ka ndërmarr masa për shuarjen e zjarrit dhe evakuimin e të burgosurve, është përdorur forcë për menaxhim të situatës, nuk janë njoftuar organet kompetent gjegjësisht policia dhe zjarrfikësit dhe kështu nga veprimet e këtij të burgosuri është shkaktuar dëm duke u dëmtuar inventari dhe muret e dhomës së të burgosurit në fjalë.

Po nga shkresat e lëndës është konstatuar se Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, përmes e-mailit me datë 02.07.2021 (ora 4:15 pasdite) ka njoftuar stafin udhëheqës se bartë



të gjitha kompetencat dhe autorizimet tek ankuesi si zv. Drejtor, pasi që nga data 05-07.2021 deri 09.07.2021 do të jetë në pushim vjetor.

Përkitazi me pretendimin ankimor se ankuesi nuk ka qenë përgjegjës për ngjarjen e ndodhur me datë 04.07.2021, Kolegji ka shqyrtuar përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit sipas të cilave rezultoi se Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm në mungesë të Drejtorit të Përgjithshëm është përgjegjës për menaxhimin gjithëpërfshirës të Qendrës së Paraburgimit dhe se ka përgjegjësi të drejtpërdrejt të menaxhoj personelin dhe vartësit e tij të drejtpërdrejt si dhe të inspektoj në baza ditore të gjitha zonat dhe hapësirat e Qendrës së paraburgimit, e si rrjedhojë nisur nga ky fakt si dhe duke marrë parasysh rrethanat si me lartë, Kolegji vlerëson se Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan në cilësinë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit ka cilësuar drejtë veprimet e ankuesit si shkelje të lehta disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë si dhe ka zbatuar drejtë dispozita ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht ka vepruar në pajtim me nenin 48 paragrafi 1 dhe nenin 50 paragrafi 1 të këtij Ligji me të cilin është përcaktuar se: 48.1 Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë..... 50.1 Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmi" e mbi këtë konstatim Kolegji vlerëson se janë të pa bazuar pretendimet ankimore të ankuesit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.828/2021

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar Av.
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës
- Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

